REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Drenasit
Kuvendi i Komunës

02 Nr. 060/03-10560 dt. 19/03/ 2025

Në bazë të nenit 43 të Ligjit nr. 03/L-40 për vetëqeverisje Lokale, neni 36,41dhe 42 pika 42.2 të Statutit të Komunës së Drenasit (Gllogocit), nenit 3 pika 3.7 si dhe nenit 12 pika 12.2 të Rregullores së punës të Kuvendit, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës z.Bekim Lestrani, më datë: 28.03.2025 (E premte) duke filluar në ora 10:00 në sallën e Kuvendit të Komunës.

THËRRET
MBLEDHJEN E RREGULLT TË KUVENDIT TË KOMUNËS

Mbledhja do të ketë këtë:

Rend dite:

1. Procesverbali i mbledhjes së rregullt i Kuvendit Komunal i dt. 28.02.2025.
2. Draft-propozim për ndryshim-plotësim të rregullores, për taksa, tarifa, ngarkesa, dhe gjoba 02 nr.400/03-62198 datës 28.12.2023.
3. Propozim-Vendim për dhënien në shfrytëzim afatgjatë për 35 vite, pronën e paluajtshme të komunës, me procedurë të negocimit të ofertës për pronën komunale: P-70315035-00848-0, në Krajkovë, me sipërfaqe 130000 $m^2$.
4. Propozim-Vendim për dhënien në shfrytëzim afatgjatë për 35 vite, pronën e paluajtshme të komunës, me procedurë të negocimit të ofertës për pronën komunale: P-70310053-00539-0, në Negroc, me sipërfaqe 109084 $m^2$.
5. Propozim-Vendim për dhënien në shfrytëzim afatgjatë për 35 vite, pronën e paluajtshme të komunës, me procedurë të negocimit të ofertës për pronën komunale: P-70315035-00913-0, në Krajkovë me sipërfaqe 92000 $m^2$.
6. Raport për implementimin e rekomandimeve të Raportit të auditimit me temë: Raporti i Auditimit për Pasqyrat Financiare vjetore të Komunës së Drenasit për vitin fiskal 2023;
7. Raporti vjetor i KRM " Pastrimi " për vitin 2024.
8. Raporti vjetor i NPL "Stacioni i Autobusëve-Drenas"
9. Të ndryshme.

Drenas, 19.03.2025

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Bekim Lestrani

**PROCESVERBAL**

**I mbledhjes së parë të rregullt të Kuvendit Komunal të Drenasit, mbajtur më 28.02.2025, e cila filloi në orën 10:00.**

Mbledhjen e kryesoi kryesuesi i Kuvendit Bekim Lestrani dhe deklaroi të hapura punimet e mbledhjes së rregullt të Kuvendit Komunal, ku të pranishëm ishin 26 anëtarë.
**Në mbledhje morën pjesë:** Kryesuesi i Kuvendit Bekim Lestrani (PDK), Labinot Halilaj (PDK), Arigon Sinani (PDK), Zeqir Hasi (PDK), Laurita Muhadri - Bujupi (PDK), Hamit Kastrati (PDK), Blerina Gashi (PDK), Gani Krasniqi (PDK), Fatmir Baliu (PDK), Malsore Cakiqi (PDK), Valentina Leku (PDK), Manushaqe Mulaku (PDK), Kosovare Halilaj-Karaxha (PDK), Sali Dvorani (DD), Mehedin Salihu (DD), Hamit Haxhiu (DD), Jahir Hajdari (DD), Azemine Bujupi-Gjoka (DD), Marigona Bazaj (DD), Filloreta Bujupi (VV), Drin Halilaj (VV), Arbër Halilaj (GREEN), Egzon Qorri (LDK), Mergim Pirraku (DD).

**Munguan:** Egzona Terrdevci (VV), Qendrim Mulaj (PDK), Muhamet Kurtaj (VV), Florentina Elezi-Veliu (VV), Selman Qallapeku (VV).

**Të pranishëm ishin edhe:** Kryetari i Komunës së Drenasit Ramiz Lladrovci, Arben Shala nënkryetar i Komunës së Drenasit dhe drejtorë të drejtorive.
Mbledhja do të ketë

## Rend dite:

1. Procesverbali i mbledhjes së rregullt i dt. 31.01.2025;
2. Raporti i Komisionit për shqyrtimin e kërkesave dhe ankesave të palëve për emërtim të rrugëve, rrugicave dhe vendeve tjera publike në Komunën e Drenasit për vitin 2024;
3. Propozim-vendimi për plotësim-ndryshimin e Vendimit të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi;
4. Raporti vjetor i punës së njësisë dhe auditimit të brendshëm të Komunës së Drenasit si dhe Plani i veprimit për zbatimin e rekomandimeve për vitin 2024;
5. Të ndryshme.

**Kryesuesi i Kuvendit Komunal Bekim Lestrani,** me një minutë heshtje e filloi mbledhjen në nderim të të rënëve për liri në Likoshan dhe Qirez.

**Kryesuesi i Kuvendit Komunal Bekim Lestrani,** pasi prezantoi rendin e ditës fjalën ja dha Kryetarit të Komunës Ramiz Lladrovci.

**Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci,** nëse me lejohet dhe jeni të pajtimit, auditori i brendshëm Kamer Rama tha se kanë harruar me dërguar Raportin e brendshëm të auditimit. Ai raport nuk votohet nëse e shihni të arsyeshme e sjellim edhe e vendosim si pikë të rendit të ditës nëse jo e lajm për mbledhjen tjetër.

**Kryesuesi i Kuvendit Komunal Bekim Lestrani,** hodhi në votim rendin e ditës me pikën shtesë dhe rendi i ditës kaloi me vota unanime.

**Kryesuesi i Kuvendit Komunal Bekim Lestrani,** hapi për diskutim pikën **1.** Procesverbali i mbledhjes së rregullt të Kuvendit Komunal të Drenasit më 31.01.2025. Pasi nuk pati vërejtje as diskutime, kryesuesi hodhi në votim pikën e parë të rëndit të ditës dhe kaloi me vota unanime.

**Kryesuesi i Kuvendit Komunal Bekim Lestrani,** hapi për diskutim pikën **2.** Raporti i Komisionit për shqyrtimin e kërkesave dhe ankesave të palëve për emërtim të rrugëve, rrugicave dhe vendeve tjera publike në Komunën e Drenasit për vitin 2024.

**Kryetarja e Komisionit Valentina Leku** tha se, ne si komision pas një periudhe të gjatë po raportojmë në pika të shkurta për punën tonë afërsisht dy vite, jemi duke shqyrtuar secilën kërkesë veç e veç duke u bazuar në Ligjin nr.04/L-071, për sistemin e adresave dhe Udhëzimin Administrativ për emërtimin e listës rezervë dhe vendosjes së tyre në regjistrin Komunal të adresave. Ne jemi duke punuar edhe në shkresën e Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, me rastin e emërimit dhe riemërimit të rrugëve ku duhet të kenë parasysh kriteret të cilat janë të përcaktuara në paragrafin 1.3 të nenit të Udhëzimit Administrativ 17/2019 për krijimin alfabetike për emërimin e listës rezervë dhe vendosjes së tyre në regjistrin Komunal të adresave, në bashkëpunim me Agjensionin Kadastral të Kosovës. Fillimisht ne jemi duke bërë listën rezervë dhe duhet aprovimi nga AKK-ja dhe t'i sjellim në Kuvend, ne e kemi bërë një listë por për shake që duhet me u koordinuar me AKK-në, me qenë se është në proces dhe nuk e kemi përfunduar akoma kemi vendosur ta sjellim muajin e ardhshëm.

**Mehdin Salihu,** pyeti unë kam njoftime se ka mjaft ankesa dhe a keni mundur me i shqyrtuar këto ankesa a nuk i keni shqyrtuar ende.

**Valentina Leku** tha se, ne kemi dal në terën në disa rajone, por kemi një numër të madh të kërkesave dhe ankesave. Ne kemi zgjedhur një rajon dhe kemi marr kërkesat e të

gjitha viteve p.sh nëse kemi zgjedhur Çikatovën, të gjitha kërkesat prej vitit 2020 e deri me tani i kemi grumbulluar dhe kemi me dal në terën, por është një numër shumë i madh dhe jemi në proces duke punuar.

**Beqir Kiqina,** pyeti se kur do të merret epilogu dhe sa parashihen që kërkesat me u trajtuar dhe me marrë një përgjigje të caktuar, faleminderit.

**Valentina Leku,** tha se ne nuk mundemi me dhënë një afat të caktuar, është një komision jashtëzakonisht shumë sfidues dhe e dini se cili prej jush kemi probleme dhe sfida për me dalë në terën dhe e kemi problem me e mbledh komisionin për shkak të angazhimeve të tjera, ne jemi duke u munduar me dhënë maksimumin.

**Mërgim Pirraku,** kërkoi nga komisioni me e zgjidh këtë problem sa më shpejt që është e mundur dhe ju kisha lutur të kuptohet se emërim i rrugëve është diçka shumë i rëndësishëm ajo mundë të jetë sot një rrugicë nesër mundë me qenë një rrugë tepër e rëndësishme. Unë e kam vërejtur në terren se ka pasur rrugë që janë emërtuar pa kurrfarë kriteri, unë kam respekt për çdo njeri, por kanë emërtuar rrugë ndoshta në emër të babagjyshit të vet, kështu që ju kisha lutur t'i emërtoni me të gjitha kriteret, faleminderit.

**Valentina Leku,** Mërgim kjo është njëra prej sfidave, ne pavarësisht se kush donë me emëruar me emrin e gjyshit, ne nuk mundemi me ja ndaluar, njerëzit bëjnë kërkesa si të duan mirëpo sigurisht që ne kemi kritere.

**Beqir Kiqina,** duke e parë gatishmërinë e punës së juaj dhe ju përgëzoj për angazhimin se kam qenë në kontakt të vazhdueshëm. Ne e dimë që është një komision i cili me të vërtet donë një tretman të veçantë duke shikuar se sa kanë ankesa dhe kërkesa për emra të rrugëve. A ka mundësi me shkuar gradualisht disa kërkesa të cilat nuk kanë ankesa dhe me u trajtuar me biseduar edhe me kompani përkatëse disa prej tyre me filluar me marr epilog, me u emëruar rrugët që mos me i lënë të gjitha për një herë në momentet e fundit në përfundim të mandatit, por me shkuar me disa që janë të zgjedhura dhe me ju dhënë hapësirë vetëm rasteve të cilat janë në kontest me i trajtuar dhe nëse ka nevojë për ndihmë shtesë edhe prej anëtarëve të tjerë të Kuvendit, sepse është një komision që me të vërtet donë një trajtim të veçantë.
Problemi është të rrugët aktuale që janë të emëruara në kontest, të cilat janë të emëruara dy herë, një herë në fillim dhe njëherë në përfundim të rrugës, segmentet e caktuara që nuk janë të caktuara si duhet kështu që ato që i keni shikuar në terren me filluar me procedura në vazhdim.

**Valentina Leku,** tha se unë vazhdimisht kam kërkuar ndihmë prej juve dhe prej ekzekutivit, kam kërkuar edhe informacion, falënderoj secilin që nuk ka hezituar më na dhënë informacione që ne me punuar sa me mirë në këtë drejtim. Në raportin që kemi me e sjell janë ato kërkesa që nuk kanë probleme, janë të përfunduara disa regjione që kemi dalë në tërën.

**Labinot Halilaj,** a e keni marr ndonjë raport prej komisionit paraprak, a është trajtuar edhe ai material.

**Valentina Leku,** tha se ne e kemi shikuar raportin e komisionit të kaluar dhe i kemi shikuar krejt rrugët që i kanë lënë në rezervë edhe ato të aprovuarat ky është informacioni i im që nëse ne i dërgojmë rrugët sikur pako të votohen edhe nisë njëra prej tyre nuk i ka plotësuar kushtet për me u emëruar, atëherë kthehet si pako kundër dhe bie krejt në pikën zero.

**Kryetari i Komunës së Drenasit Ramiz Lladrovci,** ky është komisioni më i vështirë që e kryen detyrën dhe që nuk kanë mundur me përfunduar edhe në mandatin e kaluar edhe në këtë mandat. Më herët i kanë bërë emërimet dhe riemërimet mbi ato rrugë pa përfunduar asnjë procedurë, prandaj është mirë edhe nëse zgjatët, se krejt këto ankesa në fund të fundin bien mbi mua. Kjo është detyrë e Kuvendit me i zgjidhë problemet e rrugëve, rrugicave, shesheve, ju e dini që plotë rrugë kanë pasur emra në votimin e parë të Kuvendit në Drenas, kanë pasur emra të tjerë sot kanë emra tjerë, një rrugë që fillon e mbaron nuk mundet me i pasur tre emra, siç i ka rruga Drenas - Komoran.
Besoi që komisioni kur të përfundon punën është mirë me i pasur parasysh këto probleme, me i zgjidhe një herë e përgjithmonë, ndryshimi i emrit të një rrugë nuk mund të bëhet brenda 10 viteve, është rregullore me ligj dhe mundet me na refuzuar MPL-ja. Sipas rregullores një herë emërohen me emra të dëshmorëve pastaj luftëtarëve të luftës së fundit, mandej me ata të luftërave të më hershme edhe të ndonjë babagjyshi që ka dhënë ndonjë kontribut, por çdo emër që vendosët duhet me e bërë një kërkesë, një shkresë, një histori të personit në fjalë, unë e falënderoj komisionin për punën që kanë bërë, sepse kanë një punë të vështirë edhe që nuk paguhet.

**Kamer Rama,** tha se sipas kërkesave të pyetësorit dhe vlerësimit të performancës së komunave, është një raport përmbledhës vjetor i aktiviteteve themelore të njësisë së auditimit të brendshëm që përfshin Planin strategjik gjatë vitit 2024 të auditimit të brendshëm. Me plane të punës i kishim paraparë që të kryheshin shtatë auditime në fusha të cilat janë me rrezikshmëri me të lartë. Të gjitha këto auditime janë kryer dhe janë përmbyllur me një raport të shkruar për menaxhmentin, gjithashtu kemi kryer edhe dy auditime për vlerësimin dhe zbatimin e rekomandimeve tona të dhëna me herët. Këto raporte çdo here janë dorëzuar në Komitetin e auditimit të brendshëm i cili ka shqyrtuara dhe aprovuar këto dhe ka nxjerr konkluzione për menaxhmentin, këto raporte kanë përfunduar gjithsej.

**Kryesuesi i Kuvendit Komunal Bekim Lestrani,** vazhdojmë me piken e tretë **3.**Propozim- vendimi për plotësim-ndryshim të Vendimit të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi. Pasi nuk pati vërejtje as diskutime, kryesuesi hodhi në votim pikën e tretë, me vota unanime kaloi edhe pika e tretë e rëndit të ditës.

**Kryesues i Kuvendit Komunal Bekim Lestrani,** hapi për diskutim pikën **4.** Raporti vjetor i punës së njësisë së auditimit të brendshëm të Komunës së Drenasit si dhe Plani i veprimit për zbatimin e rekomandimeve për vitin 2024.

**Auditor Kamer Rama,** përshëndetje për të gjithë, Raporti përmbledhës vjetor mbi aktivitet themelore të njësisë së auditimit të brendshëm ku përfshin Planin strategjik të njësisë së auditimit të brendshëm, Planin vjetor për vitin 2024, auditimin e përfunduar raportimin para komitetit të auditimit dhe para njësisë qendrore harmonizuese kujdesit për zbatimin e rekomandimeve dhe raportimin e shkallës së zbatimit të rekomandimeve si dhe aktivitete që i ka ndërmarr menaxhmenti në lidhje me adresimin e këtyre rekomandimeve gjatë vitit 2024.
Njësia e auditimit të brendshëm i kishte paraparë me plan të punës që të kryheshin shtatë auditime në fushat të cilat janë me rrezikshmëri më të lart, të gjitha këto auditime janë përmbyllur me një raport të shkruar për menaxhmentin, gjithashtu i kemi përfunduar edhe dy auditime për vlerësim dhe zbatimi të rekomandimeve tona të dhëna më herët. Këto raporte çdo herë janë dorëzuar në komitetin e auditimit të brendshëm i cili i ka shqyrtuar dhe ka aprovuar dhe i ka nxjerr konkluzionet për menaxhmentin. Raportet e auditimit gjatë vitit 2024 kanë përfunduar me 58 rekomandime për përmirësim të sistemeve ku 26 prej tyre janë të zbatuara në tersi, 27 janë në proces të zbatimit dhe 5 prej tyre në fund të vitit 2024 nuk kishte filluar ende adresimi i tyre. Gjatë verifikimit të rekomandimeve kemi verifikuar se menaxhmenti nuk kishte një afat për zbatimin e tyre, menaxhementi ka ndërmarr 61 aktivitete për implementimin e këtyre rekomandimeve ne këtë e falënderojmë menaxhmentin për angazhimet që i ka bërë dhe për aktivitetet që i ka ndërmarr për zbatimin e rekomandimeve tona.

**Kryetari i Komunës së Drenasit Ramiz Lladrovci,** unë dëshirojë me këtë rast të falënderoj zyrën e auditimit të brendshëm për punën që e ka bërë dhe për vërejtjet këshillat dhe kritikat që ka dhënë, po ashtu i falënderoj edhe të gjithë zyrtaret që i kanë harmonizuar dhe i kanë plotësuar të gjitha rekomandimet që i ka dhënë auditori i brendshëm.

**Kryesuesi i Kuvendit Komunal Bekim Lestrani,** hapi për diskutim pikën e **5.** Të ndryshme. Pasi nuk pati vërejtje, diskutime mbledhja përfundoi.

***Më gjerësisht, mbledhjen e rregullt të Kuvendit të Komunës së Drenasit, të dt. 28.02.2025 mund ta ndiqni në ueb faqen zyrtare të Komunës, në rrjetin social.*** **https://youtu.be/dS-uJiuËGdE.**

**Mbledhja përfundoi në ora 11:35.**

| | |
|---|---|
| **Procesmbajtësja** | **Kryesuesi i Kuvendit Komunal** |
| **Fakete Hoti** | **Bekim Lestrani** |

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA GLLOGOC - OPŠTINA GLLOGOC - MUNICIPALITY GLLOGOC

**Republika e Kosovës**

Republika Kosova-Republic of Kosovo

**Komuna e Drenasit**

Zyra e Kryetarit

**01- Nr** 030/01 – 10446 **dt.** 19/03/**2025**

Në bazë të nenit 58 paragrafi 1 pika (h) të Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, nenit 72 të Statutit të Komunës së Drenasit, Ligjit nr. 2004/18 për Tegetin e Brendshme, Ligji nr. 04/L-005 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2004/18 për Tregtinë e Brendshme, propozon:, Kuvendi i Komunës së Drenasit në mbledhjen e mbajtur me datën 27.07.2023 të aprovoj:

## PROPOZIM VENDIM

### Për Plotësim Ndryshimin e Rregullores Komunale për Fillimin dhe Mbarimin e Orarit të Punës së Organizatave të Bizneseve në Komunën e Drenasit

**NENI 1**

Me këtë Vendim, miratohet Plotësim ndryshimi i Rregullores Nr. 12-313-5709 i të dt. 31.01.2019.

**NENI 3**

- **Ndryshohet** Neni 15 – Pika - **15.1.**

Orari i punës për barnatore, ordinanca dhe klinika private (e hëne - e shtune)

15.1.1 Orari i punës për barnatore, ordinanca dhe klinika private do të jetë i njëjtë për të dy sezonat dhe fillon prej orës 08:00, ndërsa mbaron në orën 22:00.

15.1.2 Orari i punës për barnatoret kujdestare në Komoran dhe Drenas do të jetë:
Në sezonin veror 08:00 deri 20:00 ndërsa;
Në sezonin dimëror 08:00 deri 19:00.
(Përjashtimisht të shtunave orari i rregullt do të jetë nga ora 08:00 deri në ora 14:00)

- **Ndryshohet** Neni – Pika - **15.2.**

16 Në rast të nevojave emergjente mund të punojnë edhe jashtë orarit të rregullt (të dielave dhe gjatë festave shtetërore) sipas paragrafit 15.1.1. me një akte të veçantë.

- **Ndryshohet** Neni – Pika - **15.3.**

Barnatoret që veprojnë në afërsi të shërbimeve mjekësore të QKMF-Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare Drenas dhe QMF –Qendra e Mjekësisë Familjare Komoran do të kujdestarojnë:
Në sezonin veror nga ora 20:00 deri në 08:00 ndërsa
Në sezonin dimëror nga 19:00 deri në 08:00;
Ndërsa të shtunave orari i kujdestarisë do të filloj nga ora 14:00 deri në ora 08:00 njëjtë në të dy sezonet, si dhe dielave e festave zyrtare do të kujdestarohet 24 orë pa ndërprerë.
.

**Shtohet :** Neni – Pika - **15.4.**

Orari i kujdestarive do të përpilohet nga Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik sipas listës së caktuar për barnatoret në afërsi të shërbimeve mjekësore të QKMF-Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare Drenas dhe QMF –Qendra e Mjekësisë Familjare Komoran të caktuar nga Drejtoria e Inspekcionit çdo fund vit dhe në rast të ndryshimeve aktuale.

**NENI 3**

Kjo Rregullore hynë në fuqi 15 ditë nga dita regjistrimit dhe vlerësimit të ligjshmërisë nga MAPL-ja si dhe 7 ditë pas publikimit në Ueb faqen zyrtare të Komunës.

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA GLLOGOC - OPŠTINA GLOGOVAC - MUNICIPALITY GLLOGOC

Kryetari i Komunës

Ramiz Lladrovci

ARSYETIM

Gjatë zbatimit në praktik të Plotësim ndryshimi i Rregullores Nr. 12-313-5709 i të dt. 31.01.2019 ndjehet e nevojshme të bëhet plotësim/ndryshimi i nenit 15 të rregullores.
Bazuar në kërkesat e kohëpaskohshme të bizneseve konkretisht barnatoreve të cilat operojnë në qendër në Drenas dhe barnatoreve në qendër në Komoran lidhur me përpilimin e orarit të kujdestarive të barnatoreve, kërkohet nga ana e kryetarit të Komunës që të bëjë Plotësim ndryshimi e Rregullores Nr. 12-313-5709 i të dt. 31.01.2019.

Me respekt.

**Republika e Kosovës**
Republika Kosova-Republic of Kosovo
**Komuna e Drenasit**
Zyra e Kryetarit

**01- Nr** 462/01-10557 **dt.** 19/03/**2025**

Në bazë të nenit 58, paragrafi 1, pika (h) të Ligjit Nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale, nenit 72, të Statutit të Komunës së Drenasit, Kryetari i Komunës së Drenasit, propozon: që në bazë të nenit 12, nenit 40, lidhur me nenin 17, të Ligjit Nr. 03/L-040, për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 11, të Ligjit Nr. 06/L-092, për *Dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin c pronës së paluajtshme të komunës*, nenit 23, paragrafi 7, të Rregullores (QRK) Nr. 06/2020 për *Përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës*, Ofertës nr. 01-070/01-5375 dt. 04.02.2025, si dhe Procesverbalit nr. 01-060/03-10430 të dt. 19.03.2025, Kuvendi i Komunës së Gllogocit në mbledhjen e mbajtur me datë ___.03.2025, të aprovojë këtë:

## PROPOZIM-VENDIM

### Për dhënien në shfrytëzim afatgjatë për 35 vite, pronën e paluajtshme të komunës, me procedurë të negocimit të ofertës

1. Me këtë Propozim Vendim, propozohet dhënia në shfrytëzim afatgjatë për 35 vite, prona e paluajtshme e Komunës, kompanisë "TDI Balkans", me numër unik identifikues 812019306, të cilën e përfaqëson Iftach Ben Shlomo, me procedurën e negocimit të ofertës.

2. Prona e paluajtshme që propozohet për dhënie në shfrytëzim sipas pikës 1 të këtij propozim vendimi për dhënien e pronës komunale në shfrytëzim është:

   o P-70315035-00848-0, në Krajkovë, me sipërfaqe 130000 $m^2$, kapaciteti 9.99 MW vlera investive 5.800.000,00 €;

3. Qëllimi i dhënies në shfrytëzim të pronës se paluajtshme të Komunës sipas pikës 1 të këtij propozim vendimi është: Zhvillimi i qëndrueshëm ekonomik dhe përmbushja e interesit të përgjithshëm të qytetareve.

   3.1 Në ofertën e negociuar "TDI Balkans", planifikon investim në realizimin e projektit me kapacitet prej 9.99 MW, projekt i energjisë së ripërteritshme për prodhimin e energjisë elektrike me panele solare.

4. Të drejtat dhe obligimet e palëve do të rregullohen me kontratë në mes të kryetarit të komunës dhe kompanisë "TDI Balkans".

5. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit ne zyrën e protokollit në MAPL, si dhe 7 dite pas publikimit në faqen zyrtare të komunës.

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO - KOMUNA GLLOGOC - OPSTINA GLOGOVAC - MUNICIPALITY GLLOGOC

Kryetari i Komunës

Ramiz Lladrovci

**ARSYETIM**

Kompania “TDI Balkans” SHPK me datë 04.02.2025, ka dorëzuar ofertën Nr. 01-070/01-5375, Komunës së Drenasit, respektivisht Kryetarit të Komunës, për marrje në shfrytëzim të pronës se komunës përmes Negocimit.

Kryetari i komunës me datë 19.03.2025 sipas procesverbalit Nr. 01-060/03-10430 negocion ofertën e kompanisë, ndërsa përmes këtij propozim vendimi i propozon kuvendit të komunës që duke pasur parasysh interesin e përgjithshëm dhe zhvillimin ekonomike të komunës se Drenasit të votohet ky propozim vendim.

**Republika e Kosovës**
Republika Kosova-Republic of Kosovo
**Komuna e Drenasit**
Zyra e Kryetarit

**01- Nr** 060/03- 10430 **dt.** 19/03/ **2025**

**PROCESVERBAL**

*I takimit të kryetarit të komunës z. Ramiz Lladrovci dhe përfaqësuesit të kompanisë "TDI Balkans", z. Iftach Ben Shlomo*

Takimi filloi në ora: 09:25

Lidhur me të drejtën për dhënien e pronës komunale në shfrytëzim përmes negocimit me qëllim të investimit ashtu siç parashihet në Ligjin Nr. 06/L-092 mbi *Dhënien në Shfrytëzim të Pronës së Paluajtshme të Komunës*, Komuna e Drenasit me datë 04.02.2025, ka pranuar kërkesën për parcelën me numër P-70315035-00848-0, me numër protokolli 01-070/01-5375, nga kompania TDI Balkans Sh.p.k, për shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës përmes procedurës së negocimit të ofertave. Për këtë qëllim më datë 19.03.2025, u negociua oferta me pikat kryesore të saj si në vijim, të cilat më gjerësisht janë paraparë në planin ideor për investim:

- Sipërfaqja e kërkuar për dhënien e pronës komunale në shfrytëzim është:
    - P-70315035-00848-0, në Krajkovë, me sipërfaqe 130000 $m^2$, kapaciteti 9.99 MW vlera investive 5.800.000,00 €;

- Afati i qirasë: 35 vjet me mundësi vazhdimi
- Vlera e investimit: si më sipër
- Qiraja vjetore planifikohet të jetë 1.000 euro për megawatt (prodhimi vjetor planifikohet të jetë 9.99 MW)
- TDI Balkans synon të punësojë banorë lokalë dhe t'u japë përparësi nënkontraktorëve për mundësi punësimi në zonë.
- Pas përfundimit të punëve të ndërtimit në projekt, do të punësohen 4-5 punëtorë të përhershëm
- Pagesa e qirasë fillon ose nga fillimi i punimeve të ndërtimit ose pas 8 muajve nga marrja e lejes së fundit (Autorizimi përfundimtar nga ZRRE), varësisht se cila ngjarje vjen e para.
- Sponsorizimi i sportit, kulturës, etj. nëse i lejohet me ligj pa e dëmtuar kompaninë, në pajtim me Ligjin për Sponsorizim vetëm për komunën e Drenasit.
- Nëse TDI Balkans i lejohet me ligj të ofrojë sponsorizim në lidhje me projektin, ai do t'i drejtohet në mënyrë specifike komunës së Drenasit, duke ndjekur rregulloret për bashkëfinancim të përcaktuara në Ligjin për sponsorizim.

- Qiraja do të valorizohet çdo vit sipas indeksit të rritjes së çmimeve për mallrat dhe shërbimet e konsumit (Indeksi i inflacionit) të publikuar nga ASK, në: https://ask.rks-gov.net/Themes/PricesAndInflation.

  Një valorizim i tillë do të merret parasysh sapo i njëjti të shpallet.

- Komuna zotohet t'i japë TDI Balkans qasje në tokat komunale shtesë të nevojshme për instalimin dhe ndërtimin e infrastrukturës së parkut solar (si rrugë publike, etj.)

Takimi ka përfunduar në ora: 09.42

Procesmbajtës
Bekim Dobra

Kryetari i Komunës
Ramiz Lladrovci

REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA GLLOGOC - REPUBLIKA KOSOVO - OPŠTINA GLOGOVAC - REPUBLIC OF KOSOVO - MUNICIPALITY GLLOGOC

Investitori "TDI Balkans"
Iftach Ben Shlomo

| REPUBLIKA E KOSOVËS<br>KOMUNA GLLOGOC<br>GLLOGOC MUNICIPALITY | | | |
|---|---|---|---|
| PRANUAR | 04/02/ | 2025 | |
| Nj. Org. | Numër | Shtojca | Vlera |
| 01 | 070/01- 5375 | | |

TDI Balkans

Prishtinë, 04.02.2025

Për: **Kryetarin e Komunës të Drenasit**
**Kuvendin Komunal Drenas**

Nga: **TDI Balkans Shpk – Prishtinë**

Lënda: **Kërkesë për marrjen në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës përmes procedurës së Negocimit të ofertave nga Kryetari i Komunës**

Siç edhe jeni në dijeni në takimet që kemi pasur në vazhdimësi me ju dhe stafin tuaj, gjatë zhvillimit të projektit bazë në pronat e kontraktuara me kontratën nr. Nr. 01- 462/04- 62424 dt. 28/12/.2023, një prej dokumenteve/pëlqimeve kyçe është e drejta e kyçes një rrjetin elektrik. Pas aplikimit dhe takimeve me operatorin e transmisionit të energjisë elektrike-KOSTT, zgjidhja teknike që na është propozuar dhe lejuar është që të lidhemi direkt në linjën e tensionit të lartë 220KV, konkretisht Linja NS Drenas 1-NS Prizren 2.

Pas një analize dhe studimi që i kemi bërë këtij propozimi kemi ardhur në përfundim që një gjë e tillë ne na e rritë dukshëm koston investive, por edhe na ka sfiduar që të mendojmë që projektin bazë ta zgjerojmë/rrisim duke ia bashkangjitur edhe disa projekte të vogla të cilat mund të realizohen në pronat fqinje. Prandaj siç edhe e kemi elaboruar në takim, ne jemi të vendosur të ecim para me projektin fillestar por kemi nevojë për përkrahjen e komunës suaj që bashkërisht ta zhvillojmë projektin e nisur.

Prandaj, i drejtohemi titullit të lartëpërmendur që bazuar në nenin 8 paragrafi 1.3 dhe nenin 23 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit Nr.06/L-092 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, si dhe duke respektuar ligjet në fuqi dhe planet zhvillimore komunale, që **përmes procedurës së Negocimit të ofertave nga Kryetari i Komunës për marrjen në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës të na lejohet realizimi i projektit si në vijim:**

| Emërtimi i projektit | Nr i parcelës | Zona kadastrale | Kultura/klasa | Kapaciteti në MW | Vlera investive |
|---|---|---|---|---|---|
| **Drenas #4** | **P-70315035-00848-0** | **Krajkovë** | **Kullosë e kl. së 5** | **9.90 MW** | **~ 5.800.000,00 €** |

**projekt i energjisë së ripërtëritshme për prodhimin e energjisë elektrike me panele solare.**

Gjithashtu, pëlqimi/vendimi komunal na nevojitet për të vazhduar më tutje me kompletimin e dokumentacionit të nevojshëm për marrjen e vendimit final nga ZRRE për ndërtimin e projektit të sipërpërmendur.

Kërkesës ia bashkangjesim edhe dokumentacionin si në vijim:

- **Projektin ideor me disa të dhëna të detajuara teknike, si: vendndodhja, pozicionimi i paneleve solare, kapaciteti, etj.**
- **Fletën poseduese dhe kopjen e planit për parcelën e sipërpërmendur**
- **Dokumentet e biznesit të kompanisë**

Në pritje të një përgjigjeje pozitive ju përshëndesim përzemërsisht.

TDI Balkans Shpk

TDI Balkans SH.P.K Prishtinë

Iftach Ben Shlomo, Country manager
iftach@tdi-renewables.com
+38349784532

# Drenas PV Project

## Municipality of Drenas, Republic of Kosova

February 2025

## Introduction to TDI | Overview

# A well-established platform with profound knowledge in the renewables space...

### Overview

### Company's identity




### Geographic span



- Over 12 years of presence solid track record and capabilities in the local RES market.
- Re-entered the market in 2019, establishing a well positioned activity.
- Identified a niche in the South-Eastern Europe as next high-growth geography.
- Leveraging the first mover's advantage in the market with limited renewable capacities.

**~3.6 GW**
under development

### Track record

- **3 GW+** of initiated and developed projects
- **EUR 200m** of projects financed / refinanced
- **300 MW+** of construction management
- **130 MW** under commercial management

TDI renewables

Group overview

# Overview of the entire group with all business activities

TPI renewables — 4

## Romania

**Manager: *Mihaiela Aldea***

- +25 years of experience in RES sector
- Previously, CEO in Monsson Group
- Ex-board member of Romanian Wind Association
- Coordinated a total of +2.4 GW in RES development incl. the largest European onshore wind farm at the time, Fantanele-Cogealac 600 MW

20 staff members

- SHIKUN&BINUI — *Joint Venture*
- *Development Services*

## Poland

**Manager: *Przemyslaw Czaplinski***

- +5 years of experience in RES sector
- +25 MW in RES projects developed until RtB
- Experience in arranging long-term PPAs[1]
- External consulting and projects analysis for leading RES entities

4 staff members

- SOLAER — *Joint Venture*

## Bulgaria

**Manager: *Hemi Aharoni***

- +12 years of experience in RES sector
- +67 MW in RES projects developed until RtB
- Entrepreneur with extensive experience in the Bulgarian market

4 staff members

## Balkans

**Manager: *Ifach Ben Shlomo***

- +17 years of senior managerial positions experience
- Broad knowledge of Kosova and Balkans market environment

4 staff members

Group overview

# Overview of development portfolio

**Poland**
- JV 200 MW
- Own 215 MW
- Σ 415 MW

**Romania**
- JV 800 MW
- JV 500 MW
- Own 700 MW
- Own 100 MW
- Σ 2,100 MW

**Balkans**
- Own 45 MW
- Own 175 MW
- Σ 220 MW

**Bulgaria**
- Own 140 MW
- Σ 140 MW

# Drenas #4 PV Project

Drenas #4 project

General location

Krajkovë, Drenas



# Drenas projects

## General layout




TDI

## Single line diagram and main features

- Total power (DC): 9.996 MW
- PV modules: 14,280 in unique South Configuration
- Expected production: 13.5 GWh/Year
- *Total expected investment: EUR 6.8 million*





## Steps to Ready-to-build

**Step 1:** Municipal act that confirms the proposed Energy Project is allowed by Municipal development or spatial plans.

The application must be presented according to LAW no. 06/L–092 on allocation for use and exchange of municipal immovable property and based on Article 8 – Procedures for allocation for use of immovable property of the municipality and Article 11.

1. Documentation for business registration – to be prepared by the applicant.
2. Idea project – to be prepared by the applicant.
3. Copies of the plan - has to be required from the municipality.
4. Possession list - has to be required from the municipality.

**Step 2:** Electrical Consent / Connection agreement with the relevant system operator

**Step 3:** Environmental Consent

**Step 4:** Construction Permit

# Thank you.

info@tdi-renewables.com | www.tdi-renewables.com

**REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO**

**QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA /GOVERNMENT OF KOSOVA**

**MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS**
**MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE, PROSTORNOG PLANIRANJA I INFRASTRUKTURE**
**MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE**

**AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS/ KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA/ KOSOVA CADASTRAL AGENCY**

# KOPJA E PLANIT / KOPIJA PLANA / COPY PLAN

Zyra Kadastrale Komunale/ Opštinska Katastarska Kancelarija /Municipal Cadastral Office : GLLOGOC
Zona Kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone: Krajkovë

| Njësia/Jedinica/Unit | Tipi/Vrsta/Type | Sipërfaqja/Površina/Area m² |
|---|---|---|
| P-70315035-00848-0 | Parcelë / Parcela / Parcel | 203213 |
| P-70315035-00913-0 | Parcelë / Parcela / Parcel | 102318 |




Shkalla/Razmera/Scale: 1:6648

Punoi/Obradio/Created: Fadil Tahiri
Nënshkrimi/Potpis/Signature:
Shënim/Beleška/Note:

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - KOMUNA GLLOGOC - OPSTINA GLLOGOC - MUNICIPALITY

Data/ Data/Date: 15.05.2024
Koha/ Vreme/ Time: 02:08:25

# Republika e Kosovës

**Republika Kosova-Republic of Kosovo**

*Qeveria - Vlada - Government*

*Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës / Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture / Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure*

AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVO CADASTRAL AGENCY

# CERTIFIKATË / CERTIFIKAT / CERTIFICATE

## NJËSIA KADASTRALE / KATASTARSKA JEDINICA / CADASTRAL UNIT : P-70315035-00848-0

| | |
|---|---|
| Numri i lëndës / Broj Predmet / Case Referent Number: | 07-463-zyrtare |
| Data dhe koha e lëshimit / Datum i vreme izdavanja / Date and time of submission: | 15.05.2024 - 14:04 |
| Komuna / Opština / Municipality: | GLLOGOC / GLOGOVAC / GLLOGOC |
| Zona kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone: | Krajkovë / Krajkovo / Krajkovë |
| Zyra Kadastrale Komunale / Opštinska Katastarska Kancelarija / Municipal Cadastral Office: | GLLOGOC / GLOGOVAC / GLLOGOC |

## A. TË DHËNAT PËR NJËSINË KADASTRALE / PODACI O KATASTARSKOJ JEDINICI / CADASTRAL UNIT DATA

| Numri i njësisë kadastrale<br>Broj katastarske jedinice<br>Cad. Unit. No. | Lloji i njësisë<br>Vrsta Jedinice<br>Unit Type | Lloji i pronës<br>Vrsta imovine<br>Property Type | Zona<br>U/R<br>G/S<br>U/R | Sipërfaqja<br>Površina<br>Area<br>($m^2$) | Përshkrim<br>Opis<br>Description | Krijuar më datën<br>Uradjeno na dan<br>Created On | Azhuruar<br>Ažurirano<br>Updated |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| P-70315035-00848-0 | PARCELË / PARCELA / PARCEL | Pronë shoqërore / Drushtvena Imovina / Socially owned Land | Rural | 203213 | | | |

## A.1 ADRESA E NJËSISË KADASTRALE / ADRESA KATASTARSKE JEDINICE /CADASTRAL UNIT ADDRESS

| Vendi i quajtur<br>Mesto zvano<br>Called place | Kodi Postal<br>Poštanski Kod<br>Postal Code | Emri i rrugës<br>Naziv ulice<br>Street name | Krijuar më datën<br>Uradjeno na dan<br>Created On | Azhuruar<br>Ažurirano<br>Updated |
|---|---|---|---|---|
| ARA TE SHPIJA-RUDINA | | | | |

REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA GLLOGOC - REPUBLIC OF KOSOVO - MUNICIPALITY GLLOGOC

F. Shaqiri

Printuar nga / Odštampani od / Printed by: Fatmire.Shaqiri | P-70315035-00848-0 |

Zyrtari përgjegjës / Odgovorno lice / Official person

## A.2 LLOJI I SHFRYTËZIMIT / VRSTA KORISCENJA / TYPE OF USE

| Numri<br>Broj<br>Number | Lloji i shfrytëzimit të parcelës<br>Vrsta koriscenja parcele<br>Parcel Type Of Use | Shfrytëzimi aktual i parcelës<br>Trenutno koriscenje parcele<br>Parcel Current Use | Kualiteti i klasës<br>Kvalitet klase<br>Quality Class | Sipërfaqja (m²)<br>Površina (m²)<br>Area (m²) |
|---|---|---|---|---|
| 1 | Bujqësore/Poljoprivredno/Agriculture | Kullosat/Pašnjaci/pasture | Kullosë E Klasës 5/Pasnjak 5 Klase/5th Class Pasture | 163267 |
| 2 | Bujqësore/Poljoprivredno/Agriculture | Kullosat/Pašnjaci/pasture | Kullosë E Klasës 3/Pasnjak 3 Klase/3rd Class Pasture | 39946 |

## B. PRONARI/POSEDUESI - VLASNIK/DRŽALAC - OWNER/POSSESSOR

| Të drejtat<br>Prava<br>Rights | Emri<br>Ime<br>Name | Nr. personal<br>Licni broj<br>ID. No. | Vendbanimi<br>Prebivaliste<br>Resident | Kodi postal<br>Poštanski kod<br>Postal code | Hollësitë e adresës<br>Pojedinosti adrese<br>Address details | Pjesa e pronës<br>Deo imovine<br>Share quota | Pershkrimi<br>Opis<br>Description | Azhuruar<br>Ažurirano<br>Updated |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Posedim individual / Individualna Drzavina / Single possessor | **Komuna e Gllogocit** | 600316708 | GLLOGOC / GLOGOVAC / GLLOGOC / | | FEHMI DHE XHEVË LLADROVCI | 1/1 | | |

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA GLLOGOC - OPŠTINA GLOGOVAC - MUNICIPALITY

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë
Ministarstvo Industrije, Preduzetništva i Trgovine - Ministry of Industry, Entrepreneurship and Trade

ARBK

AGJENCIA E REGJISTRIMIT TË BIZNESEVE NË KOSOVË
KOSOVSKA AGENCIJA ZA REGISTRACIJE BIZNISA
KOSOVA BUSINESS REGISTRATION AGENCY

# CERTIFIKATË E REGJISTRIMIT
# CERTIFIKAT O REGISTRACIJI
# CERTIFICATE OF REGISTRATION

**812019306**

Numri Unik Identifikues / Jedinstveni Matični Broj / Unique Identification Number

**TDI Balkans SH.P.K.**

Emri biznesit / Naziv biznisa / Name of business

**TDI Balkans**

Emri tregtar / Trgovačko ime / Commercial name

| | |
|---|---|
| Lloji biznesit:<br>Poslovni tip:<br>Business type: | Shoqëri me përgjegjësi të kufizuara<br>Društvo sa ograničenom odgovornošću<br>Limited Liabilities Companies |
| Adresa:<br>Adresa:<br>Address: | Rruga Mujo Ulqinaku, 8/3<br>Prishtinë |
| Data e regjistrimit:<br>Datum registracije:<br>Date of registration: | 01/03/2023 |

01/03/2023

